

Dalës-Izlazës

Nr. 1-83
Br.

Data 15.06.2021
Datum

OBILIQ-OBILIC




Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 61 të Statutit të Komunës së Obiliqit, caktoj:


Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me dt.22.06.2021, (e martë) në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB)-i, 2022-2024
4. Shqyrtimi i kërkesës së DKA-së, për themelimin e Komisionit
5. Shqyrtimi i Raportit të DKA-së, sipas vendimit nr.-I-31, të dt.26.02.2021
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme



Kryesuesi i Komitetit
Burim Gërguri
Burim Gërguri



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.26.05.2021, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Burim Gërguri, Florije Jashari, Fatmir Bektashi, Hysni Mjeku, Qendresa Dubova, Linda Sadiku dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjerë: drejtorët komunal dhe përf. i IZHL-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kalu
3. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për faljen e tarifave vjetore të bizneseve private për vitin 2021
4. Dhënia në debat publik e Draft Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike
5. Shqyrtimi i raportit të Komisionit komunal për dhënien e pronave komunale
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Miratohet njëzërit rendi i ditës i cekur më lartë.

Pika e 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Komitetit ishin të pranishëm.

Pika e 2 e rendit të ditës

Miratohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

Pika e 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Ne edhe në vitin e kaluar për shkak të pandemisë i kemi liruar bizneset private nga tarifat vjetore, por edhe në këtë vit DEFZH, ka bërë kërkesë përmes zyres së Kryetarit për faljen e tarifave vjetore të bizneseve private për vitin 2021. Për një sqarim më të gjerë rreth kësaj çështjeje fjalën ia dha drejtoreshës së DEFZH-së.

Zarife Behluli – Duke marrë parasysh situatën e rendë ekonomike sidmos për bizneset, ne me kërkeë iu kemi drejtuar juve për faljen e tarifave vjetore të bizneseve private për vitin 2021. Falje nuk ka për Ndërmarrjet publike dhe bankat financiare. Ne të inkasuara i kemi 64,950 €, për vitin 2021, që në total ka qenë vlere 130,800 €, për mbledhjen e taksave i kemi 10,350 €, ndërsa vlere prej 63,500 €, është për heqjen e taksave nga ndërmarrjet private.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim kërkesën e DEFZH-së, për faljen e tarifave vjetore të bizneseve private për vitin 2021.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Draft Rregullorja për subvencionimin e energjisë elektrike ka qenë 2 herë në debat publik, 2 herë është aprovuar, por Ministritë përkatëse e kanë anuluar për mospërmbushje me akte normative të Ligjit nr. 05/L-44, për zonat e rrezikuara mjedisore të Obiliqit me rrethinë. Prandaj, ne kemi menduar që kjo Draft Rregullore gjatë këtij muaji të dalë në debat publik dhe drejtorii DSHPE-së, me ekipin e vet me gjetë mirëkuptim dhe me bë zgjidhjen e Draft Rregullores në fjalë sa i përket implementimit të ligjit në tërësi për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit me rrethinë.

Naim Miftari – Kjo Draft Rregullore 2 herë ka kalue në procedura administrative për aprovim, por e njehta është kthye nga Ministria sepse duhet të plotësohet me akte nënligjore. Ne do të bëjmë përpjekje që në kordinim me Miniustritë përgjegjëse ta aprovojmë këtë Rregullore në mënyrë që të zbatohet edhe pika e Ligjit për Obiliqin, ku thuhet se banorët e Komunës së Obiliqit të kenë një kuotë më të ulët dhe subvencionim të energjisë elektrike.

Kryesuesi – Neve, nuk na e mohon të drejtën askush që në emër të ligjit me i subvencionue familjet direkte në emër të energjisë elektrike. Po ashtu, nuk do të ketë nevojë që ne të kemi marrëveshje bashkëpunimi me KEDS-in, dhe ju e dini raportin e shpenzimeve të energjisë elektrike për çdo ekonomi familjare për vitin 2020. Prandaj, ne mundemi shumë thjeshtë me ditë se në vitin 2021, pak a shumë është konsumi i njejtë i energjisë elektrike, që me mund me i subvencionu 3,500, ose 3,600 ekonomi familjare.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht ia rekomanduan Kuvendit komunal për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet raportin e Komisionit për dhënien e pronave komunale në bazë të vendimit të Kryetarit nr.-II-112, të dt.12.02.2020. Këtu, një pjesë e pronave janë nga viti 2017, 2019, dhe 2020 që janë dhënë. Në të ardhmen raporti duhet të jetë më gjithëpërfshirës, për dhënien e pronave komunale, jo vetëm në 3 vitet e fundit, por që nga viti 2003, 2004 kur ka filluar dhënia e pronave sepse është interesi i anëtarëve të Kuvendit komunal, ta dijnë gjendjen faktike të tyre.

Hysni Mjeku – Ne e kemi pasë edhe një vendim nga Kuvendi komunal, të gjitha ato biznese që janë në kundërshtim me vendimin që e kemi lejuar, ose e keqpërdorin atë mirësi duhet prona të iu merret. Mirëpo, raporti i Komisionit nuk ka dhënë kurrfarë detalesh dhe as që e ka përcaktuar gjendjen, por shumë thjeshtë e ka dhënë gjendjen, që nuk ka të bëjë aspak kurgjë me realitet.

Kryesuesi – Realitet është sepse ata kanë dalë në terren dhe e kanë bërë një përshkrim të gjendjes faktike.

Hysni Mjeku – Ne nuk po e dijmë se cilat biznese janë efektive në këtë rast, ose destinacioni është i kundërt me atë që iu ka dhënë dhe ne kemi marrë vendim që këtyre bizneseve që keqpërdorin të iu merret prona dhe këtu nuk ka diskutim, as sekrete, vendimet janë publike. Ne jemi për atë që vendimi i Kuvendit komunal të zbatohet.

Naim Miftari – Është një punë e mirë e këtij Komisioni që ka fillue me evidentimin e të gjithë atyre që kanë qenë në proces të marrjes së pronave komunale në shfrytëzim. Unë pajtohem se ky raport nuk është gjithëpërfshirës dhe nuk janë të cekura elementet e paraqitura në kontratën e lidhur në mes të Komunës së Obiliqit dhe të gjithë atyre, që e kanë marrë pronën në shfrytëzim. Ne e presim edhe një raport shtesë të Komisionit sipas rekomandimeve të Komisionit se do ta hartojnë edhe një raport duke inspektuar gjendjen faktike në terren dhe atëherë do të debatojmë. Ne jemi për atë që të gjithë ata të cilët nuk i përmbahen kontratës të penalizohen.

Pika e 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga Musli Pajaziti, për shpronësim të rrugës në ZK Mazgit.

Kjo kërkesë i rekomandohet DPUKP-së, për shqyrtim dhe në mbledhjen e radhës të Kuvendit të japë përgjegje.

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga Sala Paci, për ndihmë financiare për ndërtim të shtëpisë.

Kjo kërkesë i rekomandohet Zyres së Kryetarit, eventualisht DSHPE-së për shqyrtim.

Kryesuesi – Kërkoj që rreth kërkesës së Kastriotit SH.P.K.për transportin publik të ushëtarëve, të cilën ia kemi drejtuar DSHPE-së, rreth ndihmës financiare që kanë kërkuar a mund ta kemi atë përgjegje.

Naim Miftari - Po, gjithsesi.


Kryesuesi – Po ashtu, kemi kërkesën nga Rruzhdin Mirena, nga banorët e Hades, lagja e re për rregullimin e rrugës dhe për energji elektrike drejtuar DSHPE-së, përgjigjen e dhënë duhet me na sjellë neve.

Mbledhja përfundoi në ora 10:40'

Bashk. prof. për punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesi i KPF

Burim Gërguri